



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 44, datë 25.09.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIME 2, 4 DHE 5 KATE MBI TOKË ME 1 KAT
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË POTAM, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekti zhvillues shoqërisë “Andi” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 2, 4 dhe 5 mbi tokë me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Potam, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Andi” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 04/08/2025